



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 750 Akti**

**Nr. 803 Vendimi**  
**Tiranë, më 1.10.2024**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Kryesuese
<b>Xhensila Pine</b>	Relatore
<b>Roland Ilia</b>	Anëtar

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Mevi Dibra, në datën 1.10.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Periand Teta**, ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**i.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në datën 15.6.2021 zhvilloi procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short, nga ku rezultoi se z. Periand Teta do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Genta Tafa (Bungo) dhe Xhensila Pine (relatore e çështjes). Kryesuese e trupit gjykues u caktua komisionerja Genta Tafa (Bungo). Anëtarët e trupit gjykues deklaruan mungesën e konfliktit të interesit.

**ii.** Me vendimin nr. 657, datë 28.4.2023, Komisioni vendosi “Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për z. Periand Teta”, me arsyetimin se në momentin e hyrjes në fuqi të kuadrit ligjor për procesin e rivlerësimit kalimtar ai ishte pezulluar

nga ushtrimi i detyrës. Trupi gjykues vlerësoi se pas pezullimit, në datën 18.7.2016, kontrata e punës si këshilltar ligjor e z. Periand Teta duhet të konsiderohej e zgjidhur, pasi kishin ndryshuar disa nga elementet thelbësore të saj, si detyra të cilën ai nuk e ushtronte më efektivisht, si dhe paga, të cilën nuk e përfitonte më lidhur me këtë detyrë.

**iii.** Ky vendim u ankimua nga Komisioneri Publik dhe çështja kaloi për shqyrtim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 35, datë 17.7.2024, vendosi prishjen e vendimit nr. 657, datë 28.4.2023, të Komisionit dhe urdhërimin e këtij të fundit të vijojë procesin e rivlerësimit kalimtar, me arsyetimin se z. Periand Teta përfshihej në rrethin e subjekteve të rivlerësimit sipas pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës, e duhet t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit.

**iv.** Kolegji i Posaçëm i Apelit, me vendimin nr. 35, datë 17.7.2024, urdhëroi Komisionin të vijojë procesin e rivlerësimit kalimtar për z. Periand Teta, me arsyetimin se: *“Pezullimi nga ushtrimi i detyrës nuk ka përfunduar marrëdhënien e punës. Nën dritën e nenit 141 të Kodit të Punës, lexuar në harmoni me dispozitat e pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës, që përcaktojnë rivlerësimin ex officio të këshilltarëve ligjorë të Gjykatës së Lartë, pezullimi apo mosushtrimi i detyrës në mënyrë efektive nuk duhet të ishte argumentuar se ka passjellë përfundimin e marrëdhënies së punës për z. Teta. Për pasojë, ky pezullim nuk ka passjellë as humbjen e statusit të subjektit të rivlerësimit nën dritën e nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe nenit 165, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, për çka duhej t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit kalimtar”*.

**v.** Në zbatim të këtij vendimi, Komisioni vijoi procesin e rivlerësimit kalimtar për z. Periand Teta, referuar vendimit të mësipërm. Në vijim, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke u kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

**vi.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pas përfundimit të hetimit të thelluar administrativ për të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, për z. Periand Teta, me vendimin nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Periand Teta, për të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji.

**vii.** Në datën 20.9.2024, subjektit të rivlerësimit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit. Trupi gjykues, pas marrjes së shpjegimeve nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. 3 vendosi të ftojë subjektin në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, u paraqit në seancën dëgjimore të datës 1.10.2024, ku kërkoi konfirmimin e tij në detyrën e ndihmësit ligjor, ose ish-ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë.

## **I. SEANCA DËGJIMORE**

**viii.** Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 1.10.2024, ora 10:00, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

**ix.** Seanca dëgjimore u ndërpre për të vazhduar me shpalljen e vendimit të trupit gjykues.

## **II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

x. Subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar, përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

xi. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Referuar vendimit nr. 2/20171 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

#### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Periand Teta, me funksion ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë, ku në përfundim ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

#### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

Komisioni kreu një hetim të pavarur bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimet nr. 2 dhe nr. 17 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaramit të bërë nga ky subjekt, të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore, administruar në dosje, nga ku ka rezultuar si vijon:

##### **1. Apartament banimi me sip. 47,5 m<sup>2</sup>, ndodhur në Pogradec**

**1.1** Subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: “*Apartament me sip. 47,5 m<sup>2</sup>, Pogradec. Vlera 3.500.000 lekë, blerë në vitin 2013, me burim kursimet*”.

**1.2** Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dokumentet: (i) certifikatë për vërtetim pronësie datë 25.6.2013, për pasurinë nr. \*\*\*, të llojit apartament, me sip. 47,5 m<sup>2</sup>, në

pronësi të z. Periand Teta; (ii) hartë treguese të regjistrimit; (iii) kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.5.2013, për pasurinë nr. \*\*\*, të llojit apartament.

**1.3** Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, dorëzuar në datën 3.3.2014, në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Apartament me sipërfaqe 47,5 m<sup>2</sup> në Pogradec, në shumën prej 3.500.000 lekësh, me burim kursimet”*.

**1.4** ASHK Drejtoria Vendore Pogradec, informoi ILDKPKI-në se subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, ka në pronësi një apartament me sip. 47,5 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, përfituar me kontratë shitblerjeje mes shtetasve Periand Teta dhe A.S.B.

**1.5** Referuar kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., lidhur në datën 30.5.2013, subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, ka blerë nga shitësi A.B apartamentin me sip. 47,5 m<sup>2</sup>, me adresë rruga “\*\*\*”, në qytetin e Pogradecit, kundrejt çmimit 3.500.000 lekë, shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale në Raiffeisen Bank, dega Pogradec.

**1.6** Vlera e pasurisë, e verifikuar, referuar vlerës mesatare të shitblerjeve në tregun e lirë, për vitin 2013, për qytetin e Pogradecit rezultoi se është 2.565.000 lekë.

**1.7** Me shkresën e FSHU-së konfirmohet se z. Periand Teta rezulton abonent me kontratë furnizimi energjie elektrike në instancën Pogradec, hapur në datën 25.7.2013.

**1.8** Në pyetësin standard, subjekti në lidhje me këtë pasuri ka deklaruar: *“Me qëllim blerjen e pasurisë së paluajtshme, e llojit apartament, me sipërfaqe 47,5 m<sup>2</sup>, me adresë rruga “\*\*\*”, Pogradec dhe regjistruar pranë ZVRPP-së Pogradec, në datën 30.5.2013 (datë para fillimit të detyrës) kam marrë borxh së bashku me nënën time shumën 3.500.000 lekë nga motra ime J.K.T”*.

**1.9** Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë burimin e krijimit të pasurisë apartament në DPV-në e vitit 2014 para fillimit të detyrës, si dhe në deklaratën *Vetting*, pasi nuk ka deklaruar se për blerjen e kësaj pasurie ka shërbyer si burim huaja në shumën 3.500.000 lekë, marrë nga motra e tij.

**1.10** Komisioni nëpërmjet pyetësit nr. 2 në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie, shpjegoi se: *“Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, sqaroj se për shkak se në momentin e blerjes së kësaj pasurie një pjesë e kursimeve tona ishin investuar në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë apo depozita bankare me interes, ndërsa pjesa tjetër e likuiditetit ishte planifikuar për shpenzime në raste të veçanta, për pagesën në datën 30.5.2013 shumën prej 3.500.000 lekësh, unë dhe nëna ime e kemi marrë hua nga motra ime, J.K”*.

#### **Lidhur me burimin e deklaruar të të ardhurave dhe mundësinë financiare**

**1.11** Referuar kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., lidhur në datën 30.5.2013, subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, ka blerë nga shitësi A.B apartamentin me sip. 47,5 m<sup>2</sup>, me adresë rruga “\*\*\*”, në qytetin e Pogradecit, kundrejt çmimit 3.500.000 lekë, likuiduar nëpërmjet Raiffeisen Bank, dega Pogradec.

**1.12** Në pyetësin nr. 2, subjekti i rivlerësimit, i pyetur në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, ka shpjeguar se: *“Kjo pasuri është siguruar përpara fillimit të detyrës si ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë (4.2.2014), si dhe përpara periudhës së të qenit subjekt deklarimi i interesave privatë pranë ILDKPKI-së.*

**1.13** Subjekti i rivlerësimit ka vendosur në dispozicion: (i) deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.8.2024, të motrës, znj. J.K; (ii) shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.8.2024, nga departamenti i burimeve njerëzore të punës së motrës; (iii) 3 *statement*-et për llogarinë bankare të motrës, znj. J.K; (iv) vërtetimin e debitimit nga Raiffeisen Bank, në llogari personale të z. Periand Teta, datë 31.5.2013; (v) 3 *statement*-et bankare të llogarive të subjektit të rivlerësimit, z. Periand Teta; (vi) vërtetimin për depozitim për të tretë nga Raiffeisen Bank, në datën 30.12.2013, me përshkrimin “Shlyerje borxhi në vlerën 2.900.000 lekë”; (vii) mandatpagesën, me datë 9.5.2014, në emër të nënës së subjektit, znj. A.T.

**1.14** Në vlerësim të faktit se subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur, deklaruar në cilësinë e huadhënëses, kanë konfirmuar këtë marrëdhënie referuar pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, ata kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të likuiditeteve të dhëna hua, përdorur si burim krijimi.

#### **Analizë e burimit të të ardhurave të huadhënëses, motrës së subjektit**

**1.15** Komisioni kreu analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie sipas dokumentacionit të administruar, duke marrë në konsideratë blerjen e pasurisë apartament në Pogradec, sipas kontratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.5.2013, në shumën 3.500.000 lekë.

**1.16** Subjekti i rivlerësimit si dokumentacion provues për punësimin e së motrës, znj. J.K.T, ka bashkëlidhur me pyetësin nr. 2:

- i) shkresën kthim përgjigjeje për të ardhurat nga paga të motrës, për periudhën e punësimit mars 2001 – maj 2013;
- ii) *statement*-in i llogarisë bankare, ku janë kredituar pagat nga data 1.4.2011.

**1.17** Nga verifikimi i llogarisë bankare në emër të motrës së subjektit, rezultoi se në datën 4.2.2013 ajo ka tërhequr nga llogaria, në të cilën i kreditohej paga, shumën 2.800.0000 lekë.

**1.18** Komisioni kreu analizën financiare për krijimin e shumës së tërhequr në bankë për motrën e subjektit të rivlerësimit, me burim të ardhurat nga paga, duke filluar nga viti 2011.

**1.19** Nga analiza financiare rezultoi se personi tjetër i lidhur, motra e subjektit të rivlerësimit, ka pasur mundësi financiare për dhënien hua të shumës 3.500.000 lekë, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në Pogradec nga subjekti i rivlerësimit sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.5.2013.

**1.20** Nga verifikimi i llogarisë bankare, në emër të subjektit të rivlerësimit pranë Raiffeisen Bank rezulton se në datën 30.5.2013 subjekti derdh në këtë llogari shumën 25.000 euro, me përshkrimin “Periand P. Teta derdh me kurs preferencial 140.8 kursime dhe hua”.

**1.21** Në datën 31.5.2013, nga kjo llogari paguhet shuma 25.000 euro nga subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, me transfertën me përshkrim “Blerje apartamenti”.

**1.22** Në pyetësin nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si dokumentacion provues për shlyerjen e detyrimit të marrë hua nga motra mandat depozitimin për të tretë të Raiffeisen Bank, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, depoziton *cash* në llogarinë pranë kësaj banke, në emër të shtetasit A.K, në datën 30.12.2013, shumën 2.900.000 lekë, me përshkrimin “Periand Teta derdh për shlyerje borxhi”.

**1.23** Nga hetimi i kryer dhe verifikimi i llogarive bankare, rezulton se subjektit të rivlerësimit, z. Periand Teta, i kreditohet në llogarinë në emër të tij pranë Intesa Sanpaolo Bank nga bonot e thesarit shuma 2.286.300 lekë.

**1.24** Po në këtë datë, 30.12.2013, subjekti i rivlerësimit tërheq nga kjo llogari shumën 2.485.000 lekë, me përshkrimin “Tërheq Periand Teta, shpenzime shlyerje borxhi”.

**1.25** Gjithashtu, në datën 9.5.2014, personi i lidhur me subjektin, znj. A.T (nëna e subjektit të rivlerësimit), depoziton *cash* në llogarinë e pagës, në emër të znj. J.K, shumën 400.000 lekë, me përshkrimin “A.T/shlyerje borxhi”.

**1.26** Në datën 7.5.2015, subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, transferon nga llogaria personale në llogarinë në emër të znj. J.K shumën 200.000 lekë, me përshkrimin “Periand Teta, shlyerje huaje”.

**1.27** Në lidhje me shlyerjen e detyrimit në shumën 200.000 lekë, në pyetësin nr. 2, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“Nëna ime më ka dhënë shumën prej 110.000 lekësh dhe diferenca prej 90.000 lekësh është transferuar nga llogaria ime e kursimit në llogarinë rrjedhëse, nëpërmjet së cilës është bërë transferimi për shlyerjen e detyrimit të mbetur”*.

**1.28** Komisioni vlerësoi të kryejë analizën financiare për krijimin e shumës 2.900.000 lekë, depozituar në llogarinë e shtetasit A.K, nga e cila 2.485.000 lekë janë tërhequr nga llogaria pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe 4.098 USD nga llogaria në emër të subjektit në Raiffeisen Bank, të cilat kanë shërbyer si burim për shlyerjen e huas motrës së subjektit të rivlerësimit, si dhe detyrimit të shlyer në vijim, në shumën 600.000 lekë.

**1.29** Banka e Shqipërisë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2021, ka përcjellë informacion për Komisionin në lidhje me likuiditetet në këtë bankë në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Periand Teta. Referuar informacionit, kjo llogari u çel në vitin 2007, në shumën 600.000 lekë.

**1.30** Në vijim, në këtë llogari janë kryer shtesa dhe gjendja e tyre sipas viteve është: në vitet 2008 – 2009 në shumën 1.000.000 lekë; në vitin 2010 në shumën 1.500.000 lekë; në vitet 2011 – 2012 në shumën 2.300.000 lekë.

**1.31** Nga analiza financiare, e kryer lidhur me çeljen e llogarisë bankare dhe depozitimet në vijim në të, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për krijimin e likuiditeteve bankare, me burim nga kursimet, tërhequr për shlyerje detyrimi.

**Tabela nr. 1**

<b>Periudha</b>	<b>1993 – 30.12.2013</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>22.861.350</b>
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të subjektit të rivlerësimit, periudha 10.5.2005 – 30.12.2013	4.334.764
Te ardhura të përfituara si ekspert ligjor në projekte, periudha 2011 – 2013	1.706.813
Të ardhura nga shitje e pasurisë me pjesë takuese 1/6, datë 11.6.2007	50.000
Të ardhura nga shitja e automjetit tip “***”, datë 31.10.2009	100.000
Të ardhura nga shitja e pasurisë apartament, datë 27.8.2001	2.000.000
Të ardhura neto të babait të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1993 – 2013	7.940.708
Të ardhura neto të nënës së subjektit të rivlerësimit për periudhën 1994 – 2013	6.729.065
<b>Shpenzime</b>	<b>6.725.689</b>
Shpenzime jetike për periudhën 1993 – 2013	5.794.680
Shpenzime udhëtimi për periudhën	678.413
Shpenzime mobilimi	252.596
<b>Pasuri</b>	<b>7.677.336</b>

Krijimi i likuiditeteve në vlerën 2.900.000 lekë, tërhequr për shlyerje detyrimi	2.900.000
Apartament me sip. 94,3 m <sup>2</sup> , kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.8.2001	4.000.000
Automjet tip “***”, kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.11.2010	777.336
<b>Rezultati financiar</b>	<b>8.458.325</b>

**1.32** Sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime, lidhur me sa rezultoi se nuk është deklaruar huaja e motrës, shtetases J.K, e cila ka shërbyer si burim krijimi për këtë pasuri.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**1.33** Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ të njoftuara nga Komisioni, ka sqaruar se: *“Për sa kam parashtruar edhe në pyetësin nr. 2, paraprakisht vlerësoj se kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga ana ime në datën 3.3.2014 në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës si ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë, si dhe në deklaratën Vetting në datën 25.1.2017, me burim krijimi “kursime”.*

*Në këtë kuadër, ndonëse unë dhe nëna ime në momentin e kryerjes se pagesës kemi marrë një hua nga motra ime J.K, për sa kohë për shlyerjen e huas së motrës kanë shërbyer kursimet familjare, kam menduar se burim për blerjen e pasurisë duhet të shënoja kursimet”.*

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**1.34** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, propësimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës – arsyeton se:

**1.35** Komisioni vlerësoi se subjekti ka pasaktësi lidhur me burimin e deklaruar të krijimit të pasurisë, pasi nuk ka deklaruar si burim huan e marrë nga motra e tij, por duke marrë në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të motrës, dhe në konsideratë të faktit se kjo pasuri është krijuar përpara marrjes së detyrës prej tij, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti nuk mund të penalizohet lidhur me pasaktësisë e burimit të deklaruar, referuar ligjit nr. 84/2016.

**1.36** Ky konkluzion bazohet në vlerësimin tërësor të provave shkresore të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, nga të cilat provohet jo vetëm marrja e huas nga motra e subjektit por dhe shlyerja e saj, nëpërmjet transaksioneve bankare, përpara ushtrimit të funksionit nga ana e subjektit.

**1.37** Në përfundim, Komisioni vlerëson se pasaktësia në deklaram, e pashoqëruar me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, nuk mund të konsiderohet shkak që të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit dhe nuk përbën shkak për penalizimin e z. Periand Teta.

## **2. Automjet me vlerë 5.600 euro, blerë në vitin 2010**

**2.1** Subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: *“Autoveturë blerë në vitin 2010, në shumën 5.600 euro, me burim kursimet”.*

**2.2** Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dokumentet: (i) kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.11.2010, të automjetit tip “\*\*\*\*”; (ii) leje qarkullimi nr. \*\*\*, datë 17.11.2010, për automjetin tip “\*\*\*\*”, me targë TR \*\*\* U.

**2.3** Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, subjekti ka deklaruar: “*Autoveturë e tipit “\*\*\*\*”, në vlerën 5.600 euro, me burim kursimet*”.

**2.4** Nga dosja e automjetit, rezulton se: (i) me kontratën e shitblerjes, datë 17.11.2010, subjekti i rivlerësimit ka blerë një automjet të llojit “\*\*\*\*” kundrejt çmimit 5.600 euro nga shitësi A.V; (ii) nga certifikata e pronësisë së mjetit rrugor vërtetohet se automjeti, ka kaluar në pronësi të subjektit të rivlerësimit në datën 17.11.2010.

### **Lidhur me burimin e deklaruar të të ardhurave dhe mundësinë financiare**

**2.5** Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për pasurinë kursimet.

**2.6** Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, subjekti është pyetur në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë automjet, ku ka deklaruar: “*Automjeti është blerë në datën 17.11.2010, në vlerën 5.600 euro. Pagesa e vlerës prej 5.600 euro për blerjen e automjetit është siguruar nga tërheqja në datën 17.11.2010 e vlerës prej 830.000 lekësh nga llogaria ime personale e kursimit...*”.

**2.7** Në mbështetje të deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka vendosur në dispozicion: (i) *statement* për llogarinë bankare për z. Periand Teta; (ii) vërtetim datë 20.10.2016 nga Ministria e Drejtësisë; (iii) certifikatë të pronësisë së mjetit rrugor; (iv) vërtetime në lidhje me: të ardhura nga paga e punës si specialist dhe inspektor pranë Ministrisë së Drejtësisë për periudhën 10.5.2005 – 17.11.2010; të ardhura në datën 11.6.2007 nga shitja e 1/6-ës pjesë takuese në bashkëpronësi të pasurisë; të ardhura në datën 31.10.2009 nga shitja e automjetit tip “\*\*\*\*”; të ardhura nga marrëdhënia e punës si pedagog pranë universitetit jopublik A.U, për periudhën 4.1.2008 – 17.11.2010; interesa nga investimi në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë, për periudhën 10.5.2005 – 6.1.2010.

**2.8** Intesa Sanpaolo Bank përcolli për Komisionin informacionin se subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, ka çelur llogari pranë kësaj banke. Nga verifikimi i *statement*-it të kësaj llogarie rezulton se në datën 17.11.2010 subjekti i rivlerësimit tërheq nga kjo llogari shumën 830.000 lekë, të cilat po në këtë datë i konverton në monedhën euro, në shumën 5.600 euro, dhe i tërheq me përshkrimin “Periand Teta blerje”.

**2.9** Komisioni kreu analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie sipas dokumentacionit të administruar.

**2.10** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për pagimin e pasurisë automjet në vlerën 5.600 euro, në datën 17.11.2010.

**Tabela nr. 2**

<b>Periudha</b>	<b>2006 – 17.11.2010</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>830.000</b>
Tërheqje nga llogaria bankare Periand Teta, datë 17.11.2010, këmbyer në monedhën euro në shumën 5.600 euro	830.000
<b>Pasuri</b>	<b>777.336</b>
Blerje automjeti tip “****”, datë 17.11.2010, vlera 5.600 euro	777.336
<b>Rezultati financiar</b>	<b>52.664</b>



**2.11** Në përfundim, Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se për këtë pasuri nuk rezultojnë problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **3. Bono thesari investuar pranë Bankës së Shqipërisë, në vlerën 2.200.000 lekë**

**3.1** Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë, me burim të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit të gjyqësor të Gjykatës së Apelit nr. \*\*\*, datë 27.1.2015, në vlerën 2.200.000 lekë*”.

**3.2** Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dokumentacionin: (i) vërtetim mbi shpalljen fitues për bono thesari nga Banka e Shqipërisë në emër të z. Periand Teta, me vlerë 2.200.000 lekë; (ii) vendim i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë datë 27.1.2015.

**3.3** Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “*Bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë 2.500.000 lekë, me burim ekzekutimin e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Apelit nr. \*\*\*, datë 27.1.2015*”.

**3.4** Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “*Bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë, pakësuar me 300.000 lekë, shuma 2.200.000 lekë*”.

**3.5** Banka e Shqipërisë informoi Komisionin se nga verifikimet e kryera në regjistër për z. Periand Teta rezulton të ketë hapur llogari *cash*/tituj për blerjen e bonove të thesarit të shtetit shqiptar pranë Bankës së Shqipërisë.

**3.6** Intesa Sanpaolo Bank informoi Komisionin se në llogarinë në emër të z. Periand Teta pranë kësaj banke i është kredituar në llogari, në datën 14.7.2015, nga Ministria e Drejtësisë, shuma prej 2.883.502 lekësh, në bazë të vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 27.1.2015.

i) Në datën 27.8.2015, nga kjo llogari nga subjekti i rivlerësimit transferohet shuma 2.422.452 lekë në llogarinë në emër të tij pranë Bankës së Shqipërisë, të cilat investohen në bono thesari.

ii) Në datën e deklarimit, gjendja në llogarinë në emër të subjektit të rivlerësimit pranë Bankës së Shqipërisë, në të cilën janë investuar bono thesari, është 2.200.000 lekë, vlerë e cila përputhet me deklarimin e subjektit në deklaratën *Vetting*.

**3.7** Në përfundim, Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se për këtë pasuri nuk rezultojnë problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

### **4. Gjendje në llogari kursimi, në vlerën 10.933,50 euro**

**4.1** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: “*Gjendje në llogari kursimi në vlerën 10.933 euro, me burim kursimet*”.

**4.2** Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* nxjerrje llogarie nga Intesa Sanpaolo Bank, datë 24.1.2017, për llogari në emër të tij, me gjendje 10.933 euro.

**4.3** Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, dorëzuar më 3.3.2014 në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar: “*Gjendje në llogari kursimi në vlerën 9.115 euro, me burim kursimet*”.

**4.4** Në DPV-në e vitit 2014, në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar: “*Gjendje në llogari kursimi, pakësuar me 499.89 euro. Gjendje në vlerën 8.614,98 euro me burim kursimet*”.

**4.5** Në DPV-në e vitit 2015, në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar: “Gjendje në llogari kursimi, shtuar me 3.096.09 euro. Gjendje në vlerën 11.711,07 euro, me burim kursimet”.

**4.6** Në DPV-në e vitit 2016, në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar: “Gjendje në llogari kursimi, pakësuar me 777,57 euro. Gjendje në vlerën 10.933,5 euro, me burim kursimet”.

**4.7** Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit është pyetur nga Komisioni në lidhje me burimin e krijimit, i cili ka deklaruar se: “Kjo pasuri është siguruar nga kursimet ndër vite: (i) nga të ardhurat e përfituara nga ana e babait tim P.T deri në vitin 2007; (ii) nga të ardhurat e përfituara nga ana e nënës sime A.T deri në vitin 2017; (iii) nga të ardhurat e përfituara nga ana ime gjatë periudhës kohore 2005 – 2017”.

**4.8** Intesa Sanpaolo Bank informon se subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, ka çelur llogari pranë kësaj banke. Gjendja në këtë llogari, në datën e deklarimit, 25.1.2017, është në vlerën 10.933 euro.

**4.9** Lidhur me mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit, për krijimin e likuiditeteve në bankë, ato janë analizuar në analizën financiare të kryer, duke pasqyruar çdo vit shtesat/pakësimet përkatëse dhe nga e cila nuk janë konstatuar problematika.

**4.10** Në përfundim, Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se për këtë pasuri nuk rezultojnë problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

## **5. Gjendje në llogari rrjedhëse në vlerën 19.964 lekë**

**5.1** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën Vetting: “Gjendje në llogari rrjedhëse, në vlerën 19.964,63 lekë, me burim kursimet”.

**5.2** Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, dorëzuar në datën 3.3.2014, subjekti deklaron: “Gjendje në llogari kursimi, në vlerën 12.219,14 lekë, me burim kursimet”.

**5.3** Në DPV-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar: “Gjendje në llogari rrjedhëse, pakësuar me 1.172 lekë. Gjendje në vlerën 11.047,14 lekë, me burim kursimet”.

**5.4** Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “Gjendje në llogari rrjedhëse, shtuar me 183,37 lekë. Gjendje në vlerën 11.830,27 lekë, me burim kursimet”.

**5.5** Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “Gjendje në llogari rrjedhëse, pakësuar me 1.444,64 lekë. Gjendje në vlerën 10.385,63 lekë, me burim kursimet”.

**5.6** Intesa Sanpaolo Bank informon se subjekti i rivlerësimit ka çelur llogari pranë kësaj banke, në të cilën gjendja në datën e deklarimit, 25.1.2017, është në vlerën 19.964,63 lekë. Lidhur me mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit, për krijimin e likuiditeteve në bankë, ato janë analizuar në analizën financiare të kryer, duke pasqyruar çdo vit shtesat/pakësimet përkatëse, dhe nga e cila nuk janë konstatuar problematika.

**5.7** Në përfundim, Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se për këtë pasuri nuk rezultojnë problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

## **6. Gjendje në llogari kursimi, në vlerën 485.416 lekë**

**6.1** Në deklaratën Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Gjendje në llogari kursimi, në vlerën 485.416,86 lekë, me burim kursimet”.

**6.2** Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, dorëzuar më 3.3.2014 në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar: “Gjendje në llogari rrjedhëse, në vlerën 1.579,49 lekë, me burim kursimet”.

**6.3** Në DPV-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar: “Gjendje në llogari kursimi, shtuar me 100.074,03 lekë. Gjendje në vlerën 101.653,52 lekë, me burim kursimet”.

**6.4** Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “Gjendje në llogari kursimi, pakësuar me 98.935,16 lekë. Gjendje në vlerën 2.718,36 lekë, me burim kursimet”.

**6.5** Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “Gjendje në llogari kursimi, shtuar me 547.698,5 lekë. Gjendje në vlerën 550.416,86 lekë, me burim kursimet”.

**6.6** Intesa Sanpaolo Bank konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka çelur llogari pranë kësaj banke dhe gjendja në datën e deklarimit, 25.1.2017, është në vlerën 485.416,86 lekë.

**6.7** Lidhur me mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit, për krijimin e likuiditeteve në bankë, ato janë analizuar në analizën financiare të kryer, duke pasqyruar çdo vit shtesat/pakësimet përkatëse, dhe nga e cila nuk janë konstatuar problematika.

**6.8** Në përfundim, Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit çmon se për këtë pasuri nuk rezultojnë problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

## **7. Gjendje cash deklaruar në vlerën 1.000.000 lekë**

**7.1** Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Gjendje cash në të holla, në shumën 1.000.000 lekë, me burim kursimet”.

**7.2** Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, dorëzuar më 3.3.2014 në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar: “Gjendje cash 1.000.000 lekë, me burim kursimet”.

**7.3** Në DPV-në e viteve 2014 – 2016, subjekti nuk deklaroi shtesa/pakësime të gjendjes *cash*.

### **Lidhur me burimin e deklaruar të të ardhurave dhe mundësinë financiare**

**7.4** Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2 pyeti subjektin e rivlerësimit në lidhje me burimin e të ardhurave të gjendjes *cash*, i cili sqaroi se: “Kjo pasuri është siguruar përpara fillimit të detyrës nga kursimet ndër vite: (i) nga të ardhurat e përfituara nga ana e babait tim P.T deri në vitin 2007; (ii) nga të ardhurat e nënës sime deri në vitin 2013; (iii) nga të ardhurat e përfituara nga ana ime gjatë periudhës kohore 2005 – 2013”.

**7.5** Komisioni kreu analizën financiare për krijimin e gjendjes *cash* deklaruar në vlerën 1.000.000 lekë, sipas dokumentacionit të administruar.

**7.6** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit, dhe familjarët rezultojnë të kenë pasur mundësi financiare për krijimin e likuiditeteve *cash* në vlerën 1.000.000 lekë.

### **Tabela nr. 3**

<b>Periudha</b>	<b>1993 – 3.2.2014</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>24.001.692</b>
Të ardhura neto nga e punësimi i subjektit të rivlerësimit, 10.5.2005 – 22.2.2011	3.262.824
Të ardhura nga paga si pedagog në A.U, periudha 2008 – 2013	497.700
Të ardhura nga paga si avokat në M C & S, 28.2.2011 – 31.12.2011	525.240
Të ardhura nga KSHNJ në Ministrinë e Drejtësisë	49.000
Te ardhura të përfituara si ekspert ligjor në projekte, periudha 2011 – 2013	1.706.813

Të ardhura nga shitja e pasurisë me pjesë takuese 1/6, datë 11.6.2007	50.000
Të ardhura nga shitja e automjetit tip “****”, datë 31.10.2009	100.000
Të ardhura nga shitja e pasurisë apartament, datë 27.8.2001	2.000.000
Të ardhura neto të babait të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1993 – 3.2.2014	7.940.908
Të ardhura neto të nënës së subjektit të rivlerësimit për periudhën 1994 – 3.2.2014	6,729.065
Të ardhura nga interesat bankarë	1.140.342
<b>Shpenzime</b>	<b>6.799.021</b>
Shpenzime jetike për periudhën 1993 – 2013	5.868.012
Shpenzime udhëtimi për periudhën	678.413
Shpenzime mobilimi	252.596
<b>Pasuri</b>	<b>10.939.997</b>
Apartament me sip. 94,3 m <sup>2</sup> , datë 20.8.2001	4.000.000
Automjet “****”, datë 17.11.2010	777.336
Apartament me sip. 47.5 m <sup>2</sup> , në Pogradec. datë 30.5.2013	3.500.000
Ndryshim në likuiditete, shtesa/pakësime	2.662.661
<b>Rezultati financiar</b>	<b>6.262.674</b>

7.7 Në përfundim, Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se për këtë pasuri nuk rezultojnë problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

### **Deklarimi i personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit (nëna e subjektit)**

#### **8. Apartament me sip. 94 m<sup>2</sup>, në vlerën 4.000.000 lekë**

**8.1** Personi i lidhur me subjektin në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: “*Apartament me sip. 94 m<sup>2</sup>, blerë në vitin 2001. Rrethi: Tiranë. Vlera: 4.000.000 lekë. Burimi: Kursime dhe të ardhura nga shitja e pasurisë, në shumën 2.000.000 lekë*”.

**8.2** Personi i lidhur me subjektin i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) certifikatë për vërtetim pronësie, datë 18.6.2007, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 94 m<sup>2</sup>, në pronësi të shtetasës A.T (nëna e subjektit); (ii) kontratë shitblerjeje datë 20.8.2001, për pasurinë apartament me sip. 94,3 m<sup>2</sup>; (iii) vërtetim nga dokumenti hipotekor për pasurinë; (iv) kontratë shitblerjeje datë 11.6.2007, për pasurinë apartament, me sip. 94 m<sup>2</sup>; (v) certifikatë për vërtetim pronësie, datë 18.5.2007, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 94 m<sup>2</sup>

**8.3** Në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë pasuri ka deklaruar: “*Banoj në apartamentin në pronësi të nënës, znj. A.T, Rruga \*\*\*, Tiranë*”.

**8.4** Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Jug, konfirmon për Komisionin se apartamenti me sip. 94 m<sup>2</sup> rezulton i regjistruar në pronësi të personit të lidhur me subjektin, znj. A.T.

**8.5** Nga përmbajtja e akteve të administruara në dosjen e ASHK-së Tirana Jug rezulton: (i) me kontratë shitblerjeje datë 27.8.1993, shtetasit P.T dhe A.T kanë blerë apartamentin me sip. 75,1 m<sup>2</sup>, me çmim 20.260 lekë; (ii) me kontratë shitblerjeje datë 27.8.2001, shtetasit P.T dhe A.T kanë shitur apartamentin me sip. 75,1 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 2.000.000 lekë; (iii) më pas, me kontratë shitblerjeje datë 20.8.2001, z. P.T dhe znj. A.T kanë blerë pasurinë apartament me sip. 94.3 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 4.000.000 lekë; (iv) në datën 11.6.2007, me kontratë shitblerjeje, në datën 11.6.2007, pas çeljes së dëshmisë së trashëgimisë, znj. J.K dhe z. Periand Teta i shesin pjesën e tyre të pandarë në pasurinë apartament me sip. 94 m<sup>2</sup>, nënës, znj. A.T.

**8.6** Me shkresën e FSHU-së konfirmohet se me gjeneralitetet A.T rezulton abonent me kontratë furnizimi energjie elektrike, në instancën Tiranë, hapur në datën 31.7.2000.

**8.7** Sipas të dhënave nga UKT-ja për personin e lidhur me subjektin, znj. A.T, rezulton kontrata për shërbimet Ujësjellës-Kanalizime.

**8.8** Nga sa më lart, rezultoi se kontrata e shitblerjes datë 20.8.2001, e apartamentit në vlerën 4.000.000 lekë, është lidhur nga shtetasit P.T dhe A.T, 7 ditë përpara kontratës datë 27.8.2001.

**8.9** Subjekti i rivlerësimit, i pyetur në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, ka shpjeguar se *në kontratën e shitblerjes datë 27.8.2001, palët kanë deklaruar se shitësit P.T dhe A.T deklarojnë me vullnet të lirë se pronën ia shesin z. K.J kundrejt shumës prej 2.000.000 lekësh, shumë e cila është likuiduar përpara përpilimit të kësaj kontrate. Në rastin konkret provohet që shuma në masën 2.000.000 lekë është likuiduar nga blerësi përpara datës 27.8.2001 dhe ka shërbyer si e ardhur për likuidimin e shumës 4.000.000 lekë në datën 20.8.2024, 6 ditë përpara për blerjen e apartamentit me sip. 94 m<sup>2</sup>.*

**8.10** Trupi gjykues i ka konsideruar bindëse shpjegimet e subjektit, duke vlerësuar shumën prej 2.000.000 lekësh si burim për blerjen e apartamentit me sip. 94 m<sup>2</sup>.

#### **Lidhur me mundësinë financiare**

**8.11** Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2 pyeti subjektin e rivlerësimit në lidhje me burimin e të ardhurave, i cili shpjegoi: *“Vlera prej 4.000.000 lekësh për blerjen e pasurisë është siguruar nga të ardhurat në masën 2.000.000 lekë nga shitja e apartamentit me sip. 75.1 m<sup>2</sup>, ndërsa vlera tjetër prej 2.000.000 lekësh është siguruar nga të ardhurat e përfituara nga ana e babait, në periudhën 1.2.1962 – 20.8.2001, dhe nga nëna 16.9.1997 – 20.8.2001”.*

**8.12** Komisioni kreu analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie apartament në Tiranë, blerë në vitin 2001, në vlerën 4.000.000 lekë, sipas dokumentacionit të administruar.

**8.13** Nga analiza financiare rezultoi se familja e subjektit të rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare në shumën -67.025 lekë për krijimin e pasurisë apartament, në vitin 2001.

#### **Tabela nr. 4**

<b>Periudha</b>	<b>1993 – 20.8.2001</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>6.297.502</b>
Të ardhurat neto nga shitja e pasurisë apartament, kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.8.2001	2.000.000
Të ardhura neto të babait të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1993 – 2001	3.259.781
Të ardhura neto të nënës së subjektit të rivlerësimit për periudhën 1994 – 2001	1.037.721
<b>Shpenzime</b>	<b>2.364.527</b>
Shpenzime jetike për periudhën 1993 – 2001	2.364.527
<b>Pasuri</b>	<b>4.000.000</b>
Blerje apartamenti me sip. 94 m <sup>2</sup> , kontratë shitblerjeje datë 20.8.2001	4.000.000
<b>Rezultati financiar</b>	<b>-67.025</b>

**8.14** Në përfundim, Komisioni, në analizë të faktit se kjo situatë negative është irrelevante në një vlerësim proporcional dhe objektiv të kryer në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin, si dhe faktit se pasuria është krijuar nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit në vitin 2001, përpara se subjekti i rivlerësimit të ushtronte funksionin publik, për të cilin po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, çmon se për këtë pasuri nuk rezultojnë problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **9. Bono thesari në vlerën 600.000 lekë**

**9.1** Personi i lidhur me subjektin në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: “*Bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë. Burimi: Kursime. Vlera: 600.000 lekë*”.

**9.2** Personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* vërtetim mbi shpalljen fitues për bono thesari nga Banka e Shqipërisë në emër të shtetases A.T, me vlerë 600.000 lekë.

**9.3** Banka e Shqipërisë informon Komisionin se nga verifikimet e kryera në regjistër për shtetasen A.T (personi i lidhur me subjektin), rezulton të ketë hapur llogari *cash*/tituj për blerjen e bonove të thesarit të shtetit shqiptar pranë kësaj banke, në datën 18.4.2002, në shumën 300.000 lekë.

**9.4** Në këtë llogari, në vitin 2002 është transferuar shuma 100.000 lekë nga llogaria bankare dhe, në fund të këtij viti, gjendje likuiditeti në bono thesari 400.000 lekë.

**9.5** Në vitet 2005 dhe 2006, gjendja në llogarinë pranë Bankës së Shqipërisë, e investuar në bono thesari, është 500.000 lekë. Nga viti 2007 deri në vitin 2016 në këtë llogari gjendja e bonove është 600.000 lekë.

### **Lidhur me burimin e deklaruar të të ardhurave dhe mundësinë financiare**

**9.6** Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2 pyeti subjektin e rivlerësimit në lidhje me periudhën e krijimit të likuiditetit, i cili shpjegoi se: “*Kjo pasuri është krijuar nga të ardhurat e përfituara nga babai im gjatë periudhës 30.6.1991 – 23.1.2007, si dhe nga nëna ime A.T gjatë periudhës 1.1.1991 – 5.1.2007. Ndërkohë, nga data 5.10.2007 deri në datën 25.1.2017, kjo gjendje ka mbetur e pandryshuar*”.

**9.7** Lidhur me mundësinë financiare të familjes së subjektit të rivlerësimit për krijimin e likuiditeteve investuar në bono thesari, ato janë analizuar në analizën financiare të kryer, duke pasqyruar çdo vit shtesat përkatëse dhe nga e cila nuk janë konstatuar problematika.

**9.8** Në përfundim, Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se për këtë pasuri nuk rezultojnë problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **10. Gjendje në llogari rrjedhëse, në vlerën 312.204 lekë**

**10.1** Personi i lidhur me subjektin në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: “*Gjendje në llogari rrjedhëse Burimi: Kursime. Zotërimi: 312.204 lekë. Zotërimi 100%*”.

**10.2** Personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie nga Intesa Sanpaolo Bank, datë 24.1.2017, për llogari në emër të shtetases A.T.

**10.3** Intesa Sanpaolo Bank konfirmon se personi i lidhur me subjektin, znj. A.T, ka çelur llogari pranë kësaj banke, kjo llogari rrjedh nga investimi i fondeve në depozitë nga data 28.4.2006 dhe shtesat janë nga kreditimi i interesave bankarë. Gjendja në këtë llogari në datën e deklarimit, 25.1.2017, është në vlerën 312.204 lekë.

### **Lidhur me burimin e deklaruar të të ardhurave dhe mundësinë financiare**

**10.4** Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2 pyeti subjektin e rivlerësimit në lidhje me periudhën e krijimit të likuiditetit, i cili shpjegoi se: “*Kjo pasuri është krijuar nga të ardhurat e përfituara nga babai im gjatë periudhës 30.6.1991 – 28.4.2006, si dhe nga nëna ime A.T gjatë periudhës*

1.1.1991 – 28.4.2006. Kjo pasuri është krijuar përpara datës 28.4.2006, si dhe në periudhën 28.4.2006 – 25.1.2017 është rinovuar në mënyrë automatike çdo vit, si një depozitë më afat njëvjeçar”.

**10.5** Lidhur me mundësitë financiare të familjes së subjektit të rivlerësimit për krijimin e likuiditeteve në bankë, ato janë referuar në analizën financiare të kryer, duke pasqyruar çdo vit shtesat përkatëse dhe nga e cila nuk janë konstatuar problematika.

**10.6** Në përfundim, Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se për këtë pasuri nuk rezultojnë problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **11. Gjendje në llogari rrjedhëse, në vlerën 5.259 USD**

**11.1** Personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: “Gjendje në llogari rrjedhëse (depozitë me afat 1-vjeçar) Burimi: Kursime. Vlera 5.259 dollarë”.

**11.2** Personi i lidhur me subjektin i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* nxjerrje llogarie nga Intesa Sanpaolo Bank, datë 24.1.2017, në emër të shtetasës A.T, me gjendje 5.259 USD.

**11.3** Intesa Sanpaolo Bank konfirmon se shtetasja A.T ka çelur llogari pranë kësaj banke, e cila rrjedh nga investimi i fondeve në depozitë, ku në momentin fillestar nëna e subjektit depoziton *cash* shumën 4.400 USD. Gjendja në këtë llogari në datën e deklarimit, 25.1.2017, është në vlerën 5.259 USD.

## **Lidhur me burimin e deklaruar të të ardhurave dhe mundësinë financiare**

**11.4** Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2 pyeti subjektin e rivlerësimit në lidhje me periudhën e krijimit të likuiditetit: “Kjo llogari kursimi është hapur për herë të parë në datën 4.5.2006, në shumën 4.400 USD dhe kjo gjendje është mbyllur në mënyrë periodike, në depozitë më afat njëvjeçar, si dhe është shtuar dhe pakësuar edhe gjatë periudhës 4.5.2006 – 31.8.2012, e cila ka arritur në masën 5.142 USD dhe në datën 25.1.2017 ka arritur masën 5.259 USD. Kjo pasuri është krijuar nga të ardhurat e përfituara nga babai im, si dhe nga nëna ime A.T”.

**11.5** Lidhur me mundësinë financiare të familjes së subjektit të rivlerësimit për krijimin e likuiditeteve në bankë, ato janë referuar në analizën financiare të kryer, duke pasqyruar çdo vit shtesat përkatëse dhe nga e cila nuk janë konstatuar problematika.

**11.6** Në përfundim, Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se për këtë pasuri nuk rezultojnë problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **12. Analiza paraprake e treguesve financiarë**

**12.1** Komisioni kreu analizën e treguesve financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur me të, për periudhën nga fillimi i detyrës, në datën 3.2.2014, deri në kohën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, më 25.1.2017, mbështetur në dokumentacionin justifikues ligjor të administruar, duke analizuar burimin e deklaruar të të ardhurave për krijimin e pasurive (të paluajtshme, të luajtshme dhe likuiditete) dhe mbulimin e shpenzimeve.

**12.2** Nga analiza e përgjithshme financiare 2014 – 2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (nëna e tij) rezultuan të kenë pasur mundësi financiare për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve përkatëse.

### **13. Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e pasurisë**

**13.1** Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të tij.

**13.2** Komisioni, pas hetimit të kryer, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe kreun IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

**13.3** Sipas vlerësimit të trupit gjykues, referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, pasaktësitë e reflektuara në deklarin e burimit të përfitimit të pasurisë apartament ndodhur në qytetin e Pogradecit, janë rrethana që në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk mund të ndryshojnë përfundimin e arritur se subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, ka arritur një nivel të besueshëm të kriterit të vlerësimit të pasurisë.

### **B. KONTROLI I FIGURËS**

**14.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK), si institucioni kompetent për kontrollin e figurës, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka paraqitur pranë Komisionit raportin e deklasifikuar plotësisht, me konkluzionin se:

- *Formulari i deklarinimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.*
- *Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.*
- *Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimin të organizuar.*
- *Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Periand Teta.*

**14.1** Bazuar në informacionet e ardhura nga institucionet verifikuese në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit, rezulton se: “Për subjektin e rivlerësimit, z. Periand P. Teta, nuk administrohen informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirje në veprimtari të paligjshme”.

**14.2** Komisioni, lidhur me kriterin e figurës, nuk konstatoi indicie apo informacione sipas kërkesave të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, që mund të përbënin dyshim të arsyeshëm gjatë kryerjes së hetimit administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit.

### **15. Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

**15.1** Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, bazuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, arriti në



përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

**15.2** Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**16.** Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në: (a) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja; (b) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 165 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; (c) dokumentacionin e mbledhur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

**16.1** Në mbështetje të pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndihmësi ligjor në Gjykatën e Lartë vlerësohet bazuar në:

- a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura;
- b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

#### **Lidhur me kriterin e parë vlerësues, relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura**

##### **Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

**16.2** Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur 3 relacione të përgatitura prej tij. Analiza e tyre paraqitet më poshtë:

**Dokumenti 1.** Relacion për çështjen civile, që u përket palëve - paditës F.Sh, e paditur Bashkia F dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme F, me objekt “Njohje pronësie mbi një sipërfaqe toke truall, të ndodhur në lagjen “\*\*\*”, Fier dhe regjistrimi i saj në regjistrin e pasurive të paluajtshme”. Relacioni është i strukturuar në tri pjesë: (i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohet mosmarrëveshja objekt gjykimi, si dhe parashirohen pretendimet dhe kërkimet e palës paditëse. Vijohet me disponimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, siç ka disponuar Gjykata e Apelit Vlorë; (ii) shkaqet për rekurs të parashtruar nga Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlorë, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit; (iii) mendimi i ndihmësit, i cili fillimisht konstaton se rekursi është ushtruar brenda afatit ligjor, ndaj dhe legjitimohet *ratione temporis*, si dhe u është komunikuar palëve ndërgjyqëse. Në përfundim, ndihmësi ligjor ka sugjeruar për Kolegjin Civil se: “Për sa më sipër, mendoj se rekursi përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile”. Relacioni përmban elementet e parashikuara në nenin 21 të ligjit nr. 8588/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 25 të rregullores së brendshme të Gjykatës së Lartë, të miratuar me urdhrin nr. 214, datë 12.9.2014, të kryetarit të kësaj Gjykate. Ndihmësi ligjor ka analizuar ligjërisht shkaqet e rekursit sipas parashikimit të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe ka paraqitur propozim konkret për zgjidhjen e çështjes nga Kolegji Civil. Për t’u theksuar është edhe fakti se ndihmësi ligjor ka evidentuar në arsyetimin e tij edhe se ndërmjet të njëjtave palë ndërgjyqëse ka pasur edhe më parë një proces me të njëjtin objekt dhe vendimi i formës së prerë ishte regjistruar në ZVRPP-në përkatëse. Pra, ngrihet pretendimi se mund të jemi para

“gjësë së gjykuar”, duke arsyetuar se paditësi duhej të mbronte të drejtën e pretenduar me mjete të tjera juridike dhe jo me padinë objekt gjykimi. KLGJ-ja ka informuar se nuk ka të dhëna se cili ka qenë disponimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në çështjen e mësipërme të relatuar nga z. Periand Teta. Nga pikëpamja formale janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive dhe janë përdorur rregullisht karakteret e gjuhës shqipe.

**Dokumenti 2.** Relacion për çështjen civile që u përket palëve - paditëse T.Q, e paditur Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, me objekt “Anulimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 16.11.2009, të AKKKPronave Tiranë. Detyrimin e kësaj agjencie që të më bëjë kompensimin financiar për sipërfaqet e njohura për kompensim me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.9.1996, të ish-KKKPronave, Bashkia Tiranë”. Relacioni është i strukturuar në 3 pjesë: (i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohet mosmarrëveshja objekt gjykimi, si dhe parashtrohen pretendimet dhe kërkimet e palës paditëse, por edhe prapësimet e të paditurit. Vijohet më tej me përshkrimin se si ka disponuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, se si ka disponuar Gjykata e Apelit Tiranë; (ii) shkaqet për rekurs të parashtruara nga pala paditëse, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit; (iii) mendimi i ndihmësit, i cili fillimisht konstaton se rekursi është ushtruar brenda afatit ligjor ndaj dhe legjitimohet *ratione temporis*, si dhe u është komunikuar palëve ndërgjyqëse. Në përfundim, ndihmësi ligjor ka sugjeruar për Kolegjin Civil se: “Për sa më sipër, mendoj se rekursi përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile”. Relacioni përmban elementet e parashikuara në nenin 21 të ligjit nr. 8588/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 25 të rregullores së brendshme të Gjykatës së Lartë, të miratuar me urdhrin nr. 214, datë 12.9.2014, të kryetarit të kësaj Gjykate. Subjekti i rivlerësimit ka relatuar mosmarrëveshjen objekt gjykimi, ka cituar në mënyrë të sintetizuar disponimet dhe arsyetimet e gjykatave të faktit, ka analizuar ligjërisht shkaqet e rekursit sipas parashikimit të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe ka paraqitur propozim konkret për zgjidhjen e çështjes nga Kolegji Civil. Ndihmësi ligjor ka kërkuar që rekursi i palës paditëse të pranohet, pasi ka shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile. KLGJ-ja ka informuar se nuk ka të dhëna se cili ka qenë disponimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në çështjen e mësipërme, të relatuar nga z. Periand Teta. Nga pikëpamja formale janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive dhe përdoren rregullisht karakteret e gjuhës shqipe.

**Dokumenti 3.** Relacion për çështjen civile që i përket paditësit N.L, e paditur Banka \*\*\* sh.a., me ndërhyrës kryesor shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe personit të tretë - Zyra Përmbartimore T, me objekt “Pavlefshmëri titulli ekzekutiv kontrate kredie bankare nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.7.2005. Marrja e masës së pezullimit të veprimeve përmbartimore për zbatimin e titullit ekzekutiv kontratë kredie bankare nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.7.2005. Objekti i ndërhyrjes kryesore, i njëjtë me padinë”. Relacioni është i strukturuar në 3 pjesë: (i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohet mosmarrëveshja objekt gjykimi, si dhe parashtrohen pretendimet dhe kërkimet e palës paditëse, por edhe prapësimet e të paditurit; (ii) shkaqet për rekurs të parashtruara nga pala e paditur kundër vendimit të Gjykatës së Apelit; (iii) mendimi i ndihmësit, i cili fillimisht konstaton se rekursi është ushtruar brenda afatit ligjor, ndaj dhe legjitimohet *ratione temporis*, si dhe u është komunikuar palëve ndërgjyqëse. Në përfundim, ndihmësi ligjor ka sugjeruar për Kolegjin Civil se: “Rekursi përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.” Lidhur me relacionin e hartuar nga subjekti, ai është i plotë dhe i saktë. KLGJ-ja ka informuar se nuk ka të dhëna se cili ka qenë disponimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në çështjen e mësipërme të relatuar nga z. Periand Teta. Nga pikëpamja formale, janë

respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive dhe përdoren rregullisht karakteret e gjuhës shqipe.

Komisioni pas analizimit nuk konstatoi problematika në lidhje me tri dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

### **Përshkrimi i 5 dokumenteve ligjore të përzgjedhura me short**

**Dokumenti 1.** Relacion për çështjen që i përket kërkuarit Zyra e Gjendjes Civile e Bashkisë Sh, me objekt “Rishikim i vendimit civil të formës së prerë, nr. \*\*\*, datë 2.7.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sh”. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës së Zyrës së Gjendjes Civile Sh për rishikimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 2.7.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sh, për shkak të paraqitjes së kërkesës jashtë afatit 30-ditor”. Relacioni i subjektit të rivlerësimit është i strukturuar në 3 pjesë: (i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohet kërkesa objekt gjykimi; (ii) shkaqet për rekurs të parashtruara nga pala kërkuuese, e cila kërkon rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë me nr. 1119, datë 2.7.2003; (iii) mendimi i ndihmësit ligjor. Lidhur me relacionin e hartuar nga z. Periand Teta, konstatohet si vijon: relacioni përmban elementet e parashikuara në nenin 21 të ligjit nr. 8588/2000 dhe në nenin 25 të rregullores së brendshme të Gjykatës së Lartë. Ndihmësi ligjor ka relatuar se pala kërkuuese legjitimohet *ratione personae* t’i drejtohet me këtë kërkesë Gjykatës së Lartë. Më tej, ka marrë në analizë kërkimin e palës paditëse, duke e shqyrtuar atë në raport me provat e bashkëngjitura kërkesës së rishikimit. Kërkimi i palës kërkuuese është analizuar në raport me parashikimin e nenit 496 të Kodit të Procedurës Civile, ku është relatuar nëse kërkesa është bërë brenda afatit ligjor. Gjithashtu, është marrë në shqyrtim edhe zgjidhja në themel e çështjes, ku janë vlerësuar dhe çmuar provat e paraqitura nga pala kërkuuese. Konstatohet se analiza ligjore e ndihmësit ligjor Periand Teta është mjaft e saktë dhe se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka disponuar në përputhje me zgjidhjen e dhënë nga ndihmësi ligjor në relacionin e tij. Nga pikëpamja formale, paragrafët në relacion janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive.

**Dokumenti 2.** Relacion për çështjen, që u përket palëve - paditës S.H, kundër të paditurit D.C, me objekt “Detyrimi i të paditurit të dëmshpërblejë palën paditëse në vlerën e përcaktuar nga gjykata”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur “Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit S.H si e pambështetur në ligj dhe prova”. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs nga paditësi, duke kërkuar deklarin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në të njëjtën gjykatë. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur “Kalimin e çështjes për kompetencë Gjykatës së Apelit Tiranë”. Relacioni i subjektit të rivlerësimit është i strukturuar në 3 pjesë: (i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohet mosmarrëveshja objekt gjykimi, palët ndërgjyqëse, objekti dhe baza ligjore e padisë; (ii) shkaqet për rekurs të parashtruara nga pala paditëse kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (iii) mendimi i ndihmësit. Ndihmësi ligjor ka relatuar se pala që ka ushtruar rekursin, legjitimohet *ratione personae* t’i drejtohet me këtë kërkesë Gjykatës së Lartë. Rekursi ishte ushtruar brenda afatit ligjor dhe i ishte komunikuar palës ndërgjyqëse. Në lidhje me thelbin e kërkimit të parashtruar në rekurs, arsyeton se çështja nuk është objekt gjykimi për Gjykatën e Lartë, prandaj, ose duhet kthyer dosja administrativisht, ose të vendoset mospranim ankimi. Rezultoi se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vendosi dërgimin e çështjes për kompetencë gjykimi Gjykatës së Apelit Tiranë.

Konstatohet se propozimi i dhënë nga ndihmësi ligjor Periand Teta përputhet me vendimin (disponimin) e dhënë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në aspektin që çështja nuk ishte kompetencë e kësaj gjykate, por në kompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë. Nga pikëpamja formale, paragrafët në relacion janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive.

**Dokumenti 3.** Relacion për çështjen civile që u përket palëve - paditës S.Sh, kundër të paditurve P.I dhe E.L, me objekt “Detyrimi i palëve të paditura të kthejnë shumën 122.000 USD, si dhe interesat ligjorë të shumës, që do të rezultojnë në proces deri në ekzekutim të vendimit. Marrja e masës së përkohshme të sekuestrimit të pasurive”. Kundër vendimit të saj është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë. Kjo gjykatë ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë është ushtruar rekurs nga pala e paditur P.L, i cili ka kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në të njëjtën gjykatë. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë”. Relacioni i përgatitur nga ndihmësi Periand Teta është i strukturuar në 3 pjesë: (i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen palët ndërgjyqëse, objekti dhe baza ligjore e padisë, mosmarrëveshja objekt gjykimi, marrëdhënia kontraktore e lidhur midis palëve, të drejtat dhe detyrimet që burojnë prej saj dhe arsyeja përse pala paditëse iu drejtua gjykatës kompetente me padinë objekt gjykimi; (ii) shkaqet për rekurs të parashtruara nga pala e paditur kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, duke i listuar ato; (iii) mendimi i ndihmësit. Lidhur me relacionin e hartuar nga subjekti, konstatohet sa vijon: ndihmësi ligjor ka evidentuar në relacion disa aspekte procedurale, të cilat sipas tij janë anashkaluar nga Gjykata e Apelit gjatë atij gjykimi, kryesisht aspekte që lidhen me praninë e palëve ndërgjyqëse në proces, kur për to është pushuar gjykimi në shkallë të parë; përsëritja e hetimit gjyqësor në Apel, por pa përcaktuar saktë rrethin e provave që duhen marrë etj. Megjithatë, ndryshe nga sa ka propozuar ndihmësi ligjor, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar të drejtë vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit dhe e ka lënë atë në fuqi, duke rrëzuar si të pabazuara shkaqet e rekursit të palës së paditur. Kolegji Civil ka arsyetuar, ndër të tjera, se referuar parashikimit të nenit 472, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Civile, kërkohet që nga ana e gjykatave të faktit të jetë kryer shkelje e rëndë e normave procedurale (neni 467 i Kodit të Procedurës Civile). Në rastin konkret nuk ngrihen në rekurs dhe nuk rezulton që si Gjykata e Shkallës së Parë, edhe ajo e Apelit, të kenë shkelur dispozitat mbi juridiksionin dhe kompetencën, që përbërja e trupit gjykues të ketë qenë e parregullt apo vendimi të mos jetë nënshkruar nga anëtarët e tij, që çështja është gjykuar në mungesë të palëve, që të mos jetë formuar drejt ndërgjyqësia, të mungojnë apo të jenë të pavlefshme aktet procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit. Pra, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk i ka vlerësuar të rënda shkeljet e evidentuara në gjykimin në Gjykatën e Apelit nga ana e ndihmësit ligjor, të tilla që të çonin në cenimin e atij vendimi të dhënë nga kjo gjykatë. E rëndësishme është që ndihmësi ligjor të paraqesë saktë rrethanat e faktit, pretendimet e ngritura në rekurs, si dhe të japë mendim ligjor për mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga Gjykata e Lartë. Jo në çdo rast, mendimi i ndihmësit ligjor mund të përputhet me vendimmarrjen e Kolegjit përkatës të Gjykatës së Lartë. Nga pikëpamja formale, paragrafët në relacion janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive.

**Dokumenti 4.** Relacion për çështjen që i përket paditësit T.V, kundër të paditurit P.V, me objekt “Detyrimin e të paditurit të njohë paditësit bashkëpronarë për 13/70 pjesë të pasurisë nr.

\*\*\*, ndodhur në z. k. \*\*\*, me adresë në Korçë, rruga “\*\*\*\*”, regjistruar në vol. \*\*\*, faqe \*\*\*, e llojit truall, me sipërfaqe totale 362 m<sup>2</sup>, nga kjo truall 362 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 82.5 m<sup>2</sup>. Kërkim i pasurisë trashëgimore. Fshirjen e regjistrimeve në Zyren e Regjistrimeve të Pasurive të Paluajtshme për pasurinë me nr. \*\*\*, për sa i përket pjesëve takuese të paditësve dhe regjistrimin e pasurisë trashëgimore të shtetasit K.V, respektivisht për paditësit 13/70 pjesë të pandarë të kësaj pasurie”. Rezultoi se çështja në fjalë u shqyrtua fillimisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila ka vendosur “Pushimin e gjykimit të çështjes”. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Korçë. Kjo gjykatë ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë”. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë është ushtruar rekurs nga pala e paditur P.V, i cili ka kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë mori në shqyrtim çështjen në dhomë këshillimi, duke vendosur: “Kalimin për gjykim të rekursit të paraqitur nga pala e paditur P.V, kundër Gjykatës së Apelit Korçë”. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur “Prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues”. Relacioni është i strukturuar në 3 pjesë: (i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen palët ndërgjyqëse, objekti dhe baza ligjore e padisë, mosmarrëveshja objekt gjykimi. Vijohet me përshkrimin si ka disponuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë; (ii) shkaqet për rekurs të parashtruara nga pala e paditur kundër vendimit të Gjykatës së Apelit; (iii) mendimin e ndihmësit ligjor. Lidhur me relacionin e hartuar nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet si vijon: relacioni përmban elementet e parashikuara në nenin 21 të ligjit nr. 8588/2000 dhe në nenin 25 të rregullores së brendshme të Gjykatës së Lartë. Pasqyron saktë rrethanat e faktit, qëndrimin e gjykatave të faktit, si dhe çështjet, shkaqet e ngritura në rekurs. Konstatohet se Kolegji, ashtu sikurse edhe ndihmësi ligjor Periand Teta, vlerësoi se rekursi përmbante shkaqe nga ato që parashikohen nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile. Pra, mendimi i ndihmësit në këtë aspekt përputhet me disponimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Nga pikëpamja formale, paragrafët në relacion janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive.

**Dokumenti 5.** Relacion për çështjen që i përket paditësit S.M (N), kundër të paditurit J. (Xh) H, person i tretë Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme T, me objekt “Njohje e pavërtetësisë së dokumentit”; “Akt marrjeje i tokës në pronësi” në emër të të paditurit Xh.H, goditjen e tij për falsitet; fshirjen nga regjistri hipotekor të pasurisë së regjistruar me “Akt marrjeje i tokës në pronësi” në emër të të paditurit. Detyrimin e të paditurit të më dëmshpërblejë për përdorimin e sendit tim që prej datës 29.5.2007 dhe deri tani. Detyrimin e të paditurit të lirojë dhe dorëzojë sipërfaqen, pronë imja prej 620 m<sup>2</sup>, që mbahet padrejtësisht prej të paditurit”. Rezultoi se çështja në fjalë u shqyrtua fillimisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, e cila ka vendosur: “Pranimin e pjesshëm të padisë”. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastër. Kjo Gjykatë ka vendosur: “Prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues”. Kundër vendimit të mësipërm është ushtruar rekurs nga pala paditëse, e cila ka kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë mori në shqyrtim çështjen në dhomë këshillimi, në datën 26.11.2015, duke vendosur “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër”. Relacioni i hartuar nga subjekti i rivlerësimit është i strukturuar në 3 pjesë: (i)

rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen palët ndërgjyqëse, objekti dhe baza ligjore e padisë, mosmarrëveshja objekt gjykimi, tregohet çfarë ka disponuar Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Gjirokastër; (ii) shkaqet për rekurs të parashtruara nga pala paditëse kundër vendimit të Gjykatës së Apelit; (iii) mendimi i ndihmësit ligjor. Lidhur me relacionin e hartuar nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet si vijon: ai pasqyron saktë rrethanat e faktit, qëndrimin e gjykatave të faktit, si dhe çështjet, shkaqet e ngritura në rekurs. Ndhmësi ligjor ka relatuar se rekursi ishte ushtruar brenda afatit ligjor dhe se u ishte komunikuar palëve ndërgjyqëse. Ndhmësi ligjor ka marrë në analizë shkaqet e ngritura në rekurs nga pala paditëse dhe ka vlerësuar se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile. Rezultoi se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerësoi se rekursi nuk përmbante shkaqe nga ato që parashikohen nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile, duke vendosur mospranimin e tij. Konstatohet një përputhje e plotë midis “mendimit” të dhënë nga ndihmësi ligjor dhe mënyrës se si disponoi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin përfundimtar. Nga pikëpamja formale, paragrafët në relacion janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive.

Komisioni pas analizimit nuk konstatoi problematika në lidhje me pesë dokumentet e përzgjedhura me short.

## **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-së**

**16.3** Nga analiza e të dhënave të rezultuara nga përmbajtja e formularit të vetëvlerësimit, por edhe e akteve të tjera pjesë e dosjes së vlerësimit, të dhënat profesionale dhe etike për këtë subjekt janë marrë nga Gjykata e Lartë, ku edhe ka ushtruar detyrën si ndihmës ligjor.

## **ANALIZA E GJETJEVE**

**16.4** Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dokumenteve ligjore të vëzhguara të përzgjedhura me short; (iii) të dhënave nga burime arkivore të KLGJ-së.

### **Aftësitë profesionale**

#### *a) Njohuritë ligjore*

Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në:

- i) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura;
- ii) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

Referuar parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi për kohën kur kryhet ky proces vlerësimi profesional, për ndihmësit ligjorë pranë Gjykatës së Lartë, ndryshe nga magjistratët-gjyqtarë, nuk ka pasur të miratuar nga një organ kompetent një sistem vlerësimi profesional.

Për rrjedhojë, për ndihmësit ligjorë në Gjykatën e Lartë nuk ka kritere matëse të punës të tilla si ato që ka parashikuar sistemi i vlerësimit profesional dhe etik për magjistratët-gjyqtarë, prandaj vlerësimi i aftësive profesionale të tyre nuk ndjek detyrimisht të njëjtat rregulla, sikurse për magjistratët-gjyqtarë.

Për periudhën objekt të rivlerësimit kalimtar (8.10.2013 – 8.10.2016), subjekti Periand Teta ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor për 2 vjet e 4 muaj.

Nga 8 dokumentet e vëzhguara rezultoi se subjekti i rivlerësimit Periand Teta ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Dokumentet ligjore të vëzhguara konfirmojnë njohuritë e tij kryesisht në të drejtën civile, duke përfshirë aspektet procedurale dhe materiale, që lidhen me llojin e detyrës që ai ka ushtruar gjatë periudhës së rivlerësimit – ndihmës ligjor në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

Në 8 dokumentet e vëzhguara, rezultoi se ndihmësi ligjor Periand Teta, në çdo rast, evidenton saktë dhe qartë rrethanat e mosmarrëveshjes, vlerëson nëse rekursi është ushtruar brenda afatit ligjor, nëse pala që ka ushtruar rekursin legjitimohet *ratione personae* t’i drejtohet Gjykatës së Lartë, si dhe nëse rekursi i është drejtuar palës ndërgjyqëse respektive.

### **Aftësitë organizative**

#### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Subjekti i rivlerësimit rezulton se ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë nga data e emërimit të tij, 3.2.2014, e në vazhdim. Në datën 18.7.2016, subjekti i rivlerësimit është pezulluar përkohësisht nga detyra për një çështje, e cila nuk rezulton të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me të.

Në funksionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, subjekti ka deklaruar se në periudhën 2014 – 2016 numri i përgjithshëm i dosjeve të studiuara prej tij është 550 dhe numri i dosjeve gjyqësore të përfunduara është 513.

Diferenca prej 37 dosjesh gjyqësore ka ardhur për shkaqe të mosmarrjes vendim nga ana e Kolegjit Gjyqësor, për shkaqe si bashkim çështjesh, ekzistenca e kushteve të papajtueshmërisë, heqja dorë apo mungesa e kompetencës lëndore të Kolegjit Civil. Gjatë kësaj periudhe kohore ka trajtuar dhe relatuar pranë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë edhe 98 praktika me objekt “Pezullimi i ekzekutimit të vendimeve”, si dhe ka hartuar 124 projektvendime të çështjeve në seancë gjyqësore.

Rregullorja e brendshme e Gjykatës së Lartë ka përcaktuar si standard minimal pune për ndihmësit ligjorë përgatitjen prej tyre të studimit të të paktën 20 dosjeve gjyqësore në muaj. Për afro një vit pune të plotë, ndihmësi ligjor sipas kësaj rregulloreje duhet të studiojë 220 dosje gjyqësore në vit. Për tri vite pune, referuar rregullores së brendshme të Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor duhet të studiojë dhe përgatisë relacione për 660 dosje gjyqësore.

Rezultoi se subjekti ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor për 2 vjet e 4 muaj gjatë periudhës 8.10.2013 – 8.10.2016, ka studiuar dhe përgatitur 550 dosje gjyqësore, plus 98 praktika me objekt “Pezullimi i ekzekutimit të vendimeve”, si dhe ka hartuar 124 projektvendime të çështjeve në seancë gjyqësore. Rrjedhimisht, ka përmbushur standardin sasior të përpunimit të dosjeve gjyqësore, të parashikuar në rregulloren e brendshme të Gjykatës së Lartë.

#### *b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*

Detyrat e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë janë parashikuar në nenin 21 të ligjit nr. 8588/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, në të cilin përcaktohet se: “Ndhmësit ligjorë studiojnë ankimet, dosjet gjyqësore, përgatisin relacionet për çështjet që

*janë në gjykim duke dhënë mendimin e tyre, u përgjigjen ankesave, përgatisin materialet e nevojshme, si dhe kryejnë çdo detyrë tjetër që u ngarkohet nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë”.*

Ndihmësi ligjor nuk kryen procedura gjyqësore. Ky kriter vlerësimi shërben dhe zbatohet vetëm për gjyqtarin, duke filluar që nga data e marrjes me short të çështjes e deri në datën e përfundimit të saj me vendim përfundimtar.

### **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### *a) Etika në punë*

Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata e Lartë nuk rezultojnë të dhëna negative për etikën në punë të z. Periand Teta për periudhën gjatë së cilës ai ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë asaj gjykate. Gjithashtu, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor për shkelje disipline.

#### *b) Integriteti*

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, në formularin e vetëvlerësimit, nga të dhënat që përmbajnë dokumentet që shoqërojnë formularin e vetëvlerësimit, nga të dhënat e dërguara nga Gjykata e Lartë, por edhe nga dokumentet e vëzhguara e të përzgjedhura me short, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna negative në lidhje me imunitetin e subjektit të rivlerësimit ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

#### *c) Paanësia*

Ndihmësi ligjor nuk ka kontakte me palët ndërgjyqëse, pasi nuk është pjesëmarrës në një proces gjyqësor dhe as subjekt procedural. Ndihmësi ligjor nuk është organ vendimmarrës, por këshillues, asistues i gjyqtarit. Në 8 dokumentet e përgatitura nga ndihmësi ligjor Periand Teta nuk konstatohen elemente favorizuese apo njëanshmërie në raport me palët ndërgjyqëse pjesëmarrëse në ato procese gjyqësore që u korrespondojnë atyre relacioneve.

### **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

#### *a) Aftësitë e komunikimit*

Nga përmbajtja e dosjeve gjyqësore rezultoi se subjekti ka asistuar gjyqtaren e Gjykatës së Lartë, znj. M.A. Nga dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në aktet e përpiluara prej tij mund të vlerësohet si korrekte dhe normale.

#### *b) Aftësia për të bashkëpunuar*

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 relacionet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me gjyqtarët, me kolegët e tyre dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Ndërkohë, në asnjë prej relacioneve të vëzhguara dhe praktikave përkatëse nuk evidentohet problematikë në bashkëveprimin e subjektit të rivlerësimit me gjyqtarin, të cilin ai ka asistuar.

#### *c) Gatishmëria për t'u angazhuar*

Pas një eksperience disavjeçare si ekspert ligjor, si pedagog me kohë të pjesshme, si avokat privat, si specialist dhe më pas si inspektor në Ministrinë e Drejtësisë, subjekti i rivlerësimit në datën 3.2.2014 është emëruar ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë.



Subjekti i rivlerësimit nuk hyn në kategorinë e subjekteve që kanë detyrimin ligjor të frekuentojnë trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Për pasojë, ai nuk ka deklaruar trajnime të kryera pranë Shkollës së Magjistraturës.

#### **16.5 Vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësit ligjor Periand Teta, bazuar në rezultatet e testimit të zhvilluar në Shkollën e Magjistraturës**

Rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, ka përmbushur detyrimin e parashikuar nga neni 165, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke marrë pjesë në testimin e aftësive profesionale të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës enkas për ndihmësit ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, gjykatave administrative të shkallës së parë dhe asaj të Gjykatës Administrative të Apelit.

Shkolla e Magjistraturës ka vendosur në dispozicion të Komisionit rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, të shpallura nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Vlerësimit Elektronik (faza e parë) dhe Komisioni i Vlerësimit të Testit Profesional (faza e dytë), sipas të cilave subjekti rezulton se ka marrë në total 166 pikë.

Nga hetimi administrativ rezultoi se ndaj subjektit nuk është marrë ndonjë masë administrative dhe nuk është regjistruar pranë Komisionit asnjë denoncim nga publiku.

#### **16.6 Vlerësimi i Komisionit për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit**

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punën e tij, si dhe është eficient dhe efektiv dhe konsiderohet “i aftë”, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të shkronjës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Periand Teta:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Periand Teta, ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, më 1.10.2024.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
**Kryesuese**

**Xhensila PINE**  
**Relatore**

**Roland ILIA**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Mevi Dibra*